



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL SILVIKULTURË

Niveli IV në KSHK¹, referuar niveli IV të KEK²

S1-IV-24

Tiranë, 2024

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza evropiane e Kualifikimeve

Përmbajtja

Emërtimi i kualifikimit	4
Kodi.....	4
Kohëzgjatja	4
Niveli.....	4
Qëllimi:	4
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	4
Ofruesit	4
Data e validimit.....	4
Data e miratimit	4
Variantet e mëparshme	5
STRUKTURA E KUALIFIKIMIT.....	6
KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME.....	6
NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:	7
NjN-18-IV-0066-24 Planifikimi dhe organizimi i punës në silvikulturë	7
Rezultatet e të nxënit në njohuri	7
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	7
Kriteret e vlerësimit	7
NjN-18-IV-0067-24 Mbikëqyrja dhe zbatimi i masave silvikulturale.....	8
Rezultatet e të nxënit në njohuri	8
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	8
Kriteret e vlerësimit	8
NjN-18-IV-0068-24 Mbikëqyrja e procesit të prodhimit të materialit mbjellës	9
Rezultatet e të nxënit në njohuri	9
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	9
Kriteret e vlerësimit	9
NjN-18-IV-0069-24 Zbatimi i projekteve të pyllëzimit.....	10
Rezultatet e të nxënit në njohuri	10
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	10
Kriteret e vlerësimit	10
NjN-18-IV-0070-24 Inventarizimi dhe mbarështimi i pyjeve, kullotave, zonave të mbrojtura, faunës dhe bimëve mjekësore – eterovajore	10
Rezultatet e të nxënit në njohuri	10
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	11
Kriteret e vlerësimit	11
NjN-17-IV-0071-24 Gjeodezi dhe planifikim territori.....	12
Rezultatet e të nxënit në njohuri	12
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	12
Kriteret e vlerësimit	12
NjN-18-IV-0072-24 Zbatimi i projekteve për mbarështimin e faunës dhe organizimin e gjuetisë	13
Rezultatet e të nxënit në njohuri	13
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	13
Kriteret e vlerësimit	13
NjN-18-IV-0073-24 Monitorimi dhe vlerësimi i gjendjes së fondit pyjor/kullosor, bimëve mjekësore – eterovajore dhe të faunës.....	14
Rezultatet e të nxënit në njohuri	14

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	14
Kriteret e vlerësimit	14
NjN-18-IV-0074-24 Mbikëqyrja e zbatimit të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në silvikulturë	14
Rezultatet e të nxënit në njohuri	14
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	15
Kriteret e vlerësimit	15
NjN-23-IV-0005-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere	16
Rezultatet e të nxënit në njohuri	16
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	17
Kriteret e vlerësimit	17
NjN-18-IV-0075-24 Florikultura	17
Rezultatet e të nxënit në njohuri	17
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	18
Kriteret e vlerësimit	18
NjN-18-IV-0076-24 Teknologjia e shfrytëzimit pyjor	18
Rezultatet e të nxënit në njohuri	18
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	18
Kriteret e vlerësimit	18
NjN-18-IV-0077-24 Ligjshmëria pyjore.....	19
Rezultatet e të nxënit në njohuri	19
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	19
Kriteret e vlerësimit	19
Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:.....	19
Modalitetet e vlerësimit	20
Informacion shtesë	21
SHËNIM	21

Emërtimi i kualifikimit	SILVIKULTURË			Kodi
Kohëzgjatja	1900-2100 orë ³	Niveli	IV KSHK, referuar niveli IV të KEK	S1-IV-24
Qëllimi:	Qëllimi i kualifikimit profesional “Silvikulturë”, niveli IV-të në KSHK, referuar niveli IV të KEK, është të përgatisë punonjës me kualifikim teknik i mesëm për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me pyjet.”, si dhe “zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon. Zhvillimi te individit i ndjenjës së vetëbesimit, kultivimi i vullnetit të lirë në marrjen e vendimeve, nxitja e gatishmërisë për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për t’u zhvilluar individualisht në drejtimit emocionale, intelektuale dhe një shkallë të gjerë njohurish profesionale janë sfida të rëndësishme për arritjen e këtij qëllimi.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në institucionet e arsimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në “Silvikulturë” niveli IV në KSHK, referuar niveli IV të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që: – kanë mbaruar dy vitet e para të arsimit profesional në kualifikimin “Pyje”, niveli II në KSHK, referuar niveli II të KEK. – janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitet reale të këtyre shkollave, atëherë institucionet përgjegjëse përgatitin udhëzime të veçanta për pranimin në këto shkolla.			
Mundësitë e kualifikimit të mëtijshëm dhe të punësimit:	Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Silvikulturë”, niveli IV në KSHK, referuar niveli IV të KEK, e pajis individin me Certifikatë Profesionale dhe Suplementin përkatës, të teknikut të mesëm në këtë fushë profesionale, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky arsimim profesional i jep individit mundësi t’i drejtohet tregut të punës si teknik i mesëm i profilit pyjor. Individit mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual ose familjar në fushën e fidanishteve pyjore, kultivimit të luleve dhe drurëve dekorative, prodhimeve të dyta të pyllit, trajtimit të pyjeve, kullotave dhe gjahut, mbrojtjen nga sëmundje, dëmtues, zjarre dhe tokës nga fenomenet e erozionit. Gjithashtu ky individ mund të punësohet si udhërrëfyes turistik. Me përfundimin e këtij niveli, individit ka mundësi për të fituar të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.			
Ofruesit	Ky kualifikim duhet të ofrohet nga ofrues të akredituar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.			
Data e validimit				
Data e miratimit				

³ Orë mësimore 45 minuta

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Në përfundim të kualifikimit profesional “Silvikulturë”, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, individit duhet të zotërojë njohuritë, shprehjet profesionale dhe kompetencat e përgjithshme të ndara sipas fushave të mëposhtme:

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të përgjithshme janë të vlefshme për të gjitha njësitë e të nxënit.

1. Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme kulturore, sociale, ligjore, organizative e tekniko-profesionale.
2. Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional dhe ti shpërndajë ato, në dobi të kolegeve e punonjësve në njësisë e tij prodhuese.
3. Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente. Të ndërmarrë apo hedhë vazhdimisht ide të reja, duke hartuar projekte të reja, struktura të reja organizative, të cilat sjellin përmirësimin e strukturave ekzistuese.
4. Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
5. Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
6. Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
7. Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij, të jetë i matur dhe i sjellshëm me eprorët, vartësit, partneret, etj.
8. Të organizojë drejt procesin e të nxënit të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
9. Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
10. Të vlerësojë dhe vetë vlerësojë aftësitë e tij, nisur nga kritere të drejta, si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.
11. Të jetë i hapur dhe të veprojë si një ndërlidhës midis njësisë së tij prodhuese dhe njësive të tjera brenda ndërmarrjes apo ndërmjet ndërmarrjes dhe të tretëve jashtë saj, si furnitorët, klientët, partneret, etj., duke ndihmuar në realizimin e qëllimeve të njësisë prodhuese.
12. Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
13. Të marrë nisma për të bashkëpunuar me individë apo grupe;
14. Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollore dhe komunitet;
15. Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për qenë pjesëmarrës proaktiv në grup;
16. Të demonstrojë përgjegjshmëri ndaj mjedisit dhe të mirave publike;
17. Të pranojë dhe të promovojë rrishtë dhe ndryshimet;

18. Të demonstrojë marrjen e nismave për të zhvilluar dhe zbatuar një ide;
19. Të demonstrojë zotësi për të nxënë nga dështimet dhe për të këmbëngulur drejt arritjes së synimeve të tij/saj;
20. Të aplikojë mënyra konstruktive të përgjigjeve ndaj kritikave.

NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:

Standardet e kualifikimit hartohen në bazë të rezultateve të të nxënit (kompetenca të përgjithshme, njohuri dhe shprehje profesionale).

NjN-18-IV-0066-24 Planifikimi dhe organizimi i punës në silvikulturë

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e normativave të punës në pyje, kullota dhe bimë mjekësore eterovajore Bimët Mjekësore Eterovajore-Tanifere (BMET) sipas manualeve;
2. Të përshkruajë mënyrën e organizimit të punës për drejtimin/menaxhimin e grupeve të veçanta në varësi të procesit të punës që ato kryejnë;
3. Të shpjegojë mënyrat e hartimit të veprimtarisë mujore sipas strukturës së projektit (planit operacional të veprimtarive);
4. Të shpjegojë mënyrat e planifikimit të burimeve njerëzore sipas kualifikimeve përkatëse dhe proceseve të punës;
5. Të shpjegojë mënyrën e planifikimit të materialeve, pajisjeve, veshjeve dhe instrumenteve të nevojshme për realizimin e proceseve të punës, sipas projektit;
6. Të shpjegojë mënyrat e planifikimit të kohës së punës sipas projektit/preventivit përkatës;
7. Të shpjegojë rëndësinë e ndarjes së detyrave sipas kualifikimit të punonjësve;
8. Të shpjegojë mënyrën e organizimit të vendit të punës;
9. Të shpjegojë rëndësinë e bashkëpunimit me specialistë të tjerë;
10. Të shpjegojë mënyrat dhe formatet e raportimit tek eprorët;
11. Të shpjegojë procesin e mbikëqyrjes së pastrimit dhe sistemimit të mjeteve, pajisjeve dhe vendit të punës.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të planifikojë aktivitetet silvikulturore sipas strukturës së projektit (planit operacional të veprimtarive);
2. Të kryejë menaxhimin e burimeve materiale për realizimin e proceseve të punës;
3. Të kryejë menaxhimin e burimeve njerëzore sipas kualifikimeve përkatëse dhe proceseve të punës;
4. Të dokumentojë ecurinë e punës.

Kriteret e vlerësimit

- Planifikon veprimtaritë e punës sipas planit operacional vjetor;
- Planifikon kohën e punës sipas projektit/preventivit përkatës;

- Organizon vendin e punës, sipas standardeve të miratuara;
- Planifikon mjetet, bazën materiale, pajisjet, veshjet dhe instrumentet e nevojshme sipas kërkesave të proceseve të punës;
- Përzgjedh mjetet, bazën materiale, pajisjet dhe instrumentet e nevojshme sipas proceseve të punës;
- Mbikëqyr pastrimin dhe sistemimin e mjeteve, pajisjeve dhe vendit të punës sipas rregulloreve përkatëse;
- Planifikon burimet njerëzore të kualifikuara sipas proceseve të punës;
- Përzgjedh burimet njerëzore të kualifikuara sipas proceseve të punës;
- Bashkëpunon me specialistë të tjerë, sipas proceseve të punës;
- Plotëson dokumentacionin teknik për punën e kryer, sipas formateve të caktuara;
- Raporton për ecurinë e punës, sipas formateve duke zbatuar hierarkinë.

NjN-18-IV-0067-24 Mbikëqyrja dhe zbatimi i masave silvikulturale

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë teknikat, periodicitetin dhe zbatimin e punimeve kulturale;
2. Të shpjegojë rëndësinë e vlerësimit të materialit drusor që del nga zbatimi i prerjeve kulturale;
3. Të shpjegojë kriteret e klasifikimit të drurëve në prerje kulturale;
4. Të shpjegojë fazat e zhvillimit të grumbullit pyjor;
5. Të përshkruajë standardet e asortimit të materialit drusor të prerë;
6. Të shpjegojë mënyrat e transportit të brendshëm të materialit drusor të prerë si dhe mjetet e mekanizmat përkatës;
7. Të shpjegojë teknikat e ricungimit të pyjeve të degraduara;
8. Të shpjegojë mënyrat e grumbullimit të të dhënave dhe të plotësimit të evidencave në punimet pyjore.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të kryejë punimet silvikulturale në grumbullin pyjor;
2. Të mbikëqyrë zbatimin e punimeve silvikulturale dhe proceset e transportit të materialit drusor në grumbullin pyjor, sipas teknikës zbatimit të tyre;
3. Të vlerësojë materialin drusor që del nga zbatimi i prerjeve kulturale, rigjeneruese (ricungime), në asortimente të ndryshëm sipas standardeve të caktuara.

Kriteret e vlerësimit

- Zgjedh në bashkëpunim me inxhinierin e pyjeve llojet e drurëve që do të hiqen me prerjet kulturale, sipas fazave të zhvillimit të grumbullit pyjor;
- Mbikëqyr prerjet kulturale në grumbullin pyjor, sipas teknikave silvikulturale;
- Vlerëson materialin drusor që del nga zbatimi i prerjeve kulturale në asortimente të ndryshme sipas standardeve të caktuara;
- Mbikëqyr transportimin e materialit drusor, sipas skemës së përcaktuar;
- Mbikëqyrë ricungimin e pyjeve të degraduara duke zbatuar teknikat përkatëse;
- Plotëson evidencat sipas punimeve të kryera.

NjN-18-IV-0068-24 Mbikëqyrja e procesit të prodhimit të materialit mbjellës

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë rezervatet farore të certifikuar;
2. Të shpjegojë llojet pyjore dhe fazat fenologjike të tyre;
3. Të shpjegojë teknikat e grumbullimit të farës dhe materialit vegjetativ;
4. Të shpjegojë teknikat e tharjes, trajtimit dhe përgatitjes së farës për mbjellje dhe ruajtje;
5. Të shpjegojë mënyrat kontrollit të punimit të tokës në fidanishte dhe serra;
6. Të shpjegojë mënyrën e organizimit të fidanishtes në sektorë (farishtore, shpërngultore dhe kalemtoze);
7. Të shpjegojë teknikat e kontrollit të mbjelljes së farave, kalemave, shpatullave dhe rizomave;
8. Të shpjegojë teknikat e kontrollit të shërbimeve kulturore në fidanishte dhe mënyrat e kryerjes së tyre;
9. Të klasifikojë llojet e sëmundjeve dhe dëmtuesve kryesor në fidanishte;
10. Të shpjegojë masat mbrojtëse ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve në fidanishte;
11. Të përshkruajë standardet e fidanëve sipas llojeve dhe moshës;
12. Të shpjegojë teknikat e shkëlqes, ambalazhimit dhe etiketimit të fidanëve;
13. Të shpjegojë mënyrat e zhvendosjes së fidanëve nga farishtorja në shpërngultore;
14. Të shpjegojë mënyrat e transportit të fidanëve;
15. Të shpjegojë procesin e shtratifikimit të fidanëve dhe masat e tjera mbrojtëse.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të mbikëqyrë proceset e sigurimit dhe prodhimit të materialit mbjellës dhe riprodhues pyjor;
2. Të mbikëqyrë proceset e punimit të tokës dhe organizimit të fidanishtes pyjore;
3. Të marrë masa paraprake për mbrojtjen nga sëmundjet dhe dëmtuesit e materialit mbjellës në fidanishte dhe në objektin e pyllëzimit sipas udhëzuesve përkatëse;
4. Të mbikëqyrë organizimin e shkëlqes, seleksionimit, ambalazhimit, etiketimit të fidanëve dhe transportin e tyre në objektin e pyllëzimit.

Kriteret e vlerësimit

- Identifikon rezervatet dhe drurët farorë sipas standardeve të miratuara;
- Mbikëqyr grumbullimin e farave, frutave dhe materialit tjetër riprodhues, sipas teknikave përkatëse;
- Mbikëqyr përdorimin e farave, frutave dhe materialit tjetër riprodhues të certifikuar sipas standardeve përkatëse;
- Mbikëqyr procesin e seleksionimit, tharjes, trajtimit dhe përgatitjes së farës për mbjellje, sipas llojeve pyjore;
- Mbikëqyr procesin e grumbullimit dhe depozitimit të materialit vegjetativ sipas llojeve pyjore;
- Mbikëqyr procesin për përcaktimin e fuqisë mbirëse të farave pyjor, sipas llojeve pyjore;
- Organizon proceset e punimit, plehërimit të tokës, mbjelljes së farave dhe materialit tjetër riprodhues në fidanishte, sipas projektit;
- Zbaton teknologjinë e mbjelljes së farave dhe materialit vegjetativ në mjedise të mbyllura dhe të hapura në fidanishte, sipas standardit;

- Organizon proceset e zhvendosjes së fidanëve (tranzitimin) nga farishtorja në shpërngultore, kryerjes së shërbimeve kulturale dhe masat paraprake për mbrojtjen nga sëmundjet dhe dëmtuesit si dhe luftimin e tyre në fidanishte, sipas projektit;
- Organizon shkulljen, seleksionimin, ambalazhimin, etiketimin dhe transportin e fidanave për në objektin e pyllëzimit, sipas kalendarit të punimeve, standardeve dhe udhëzuesve teknikë;
- Merr masa mbrojtëse për fidanët në objektin e pyllëzimit, para, gjatë dhe pas mbjelljes tyre, sipas parashikimeve në projekt.

NjN-18-IV-0069-24 Zbatimi i projekteve të pyllëzimit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë mënyrat e piketimit të objektit sipas skemës së pyllëzimit;
2. Të shpjegojë mbikëqyrjen e procesit të hapjes së gropave, ndërtimit të shesheve dhe gradonave, sipas kushteve teknike;
3. Të shpjegojë procesin e mbjelljes së materialit mbjellës dhe riprodhues pyjor, sipas standardeve;
4. Të shpjegojë mënyrat e inventarizimit të zënies së fidanëve;
5. Të shpjegojë mënyrat e zëvendësimit të fidanëve pyjorë në objektin e pyllëzimit;
6. Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të kryerjes së shërbimeve kulturale pas mbjelljes së fidanëve;
7. Të shpjegojë mënyrat e plotësimit të evidencave në punimet e pyllëzimeve.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të mbikëqyrë kryerjen e punimeve në objektet e pyllëzimit sipas fazave;
2. Të kontrollojë cilësinë e kryerjes së punimeve (sheshe, gradona dhe hapje gropash) për mbjelljen e fidanëve pyjorë;
3. Të inventarizojë përqindjen e zënies së fidanëve pyjorë.

Kriteret e vlerësimit

- Piketon objektin sipas skemës së pyllëzimit;
- Siguron mjetet e punës, materialin mbjellës (fara, fidanë, shpatulla, kalema), që përdoren në pyllëzime, sipas projektit;
- Kontrollon cilësinë e kryerjes së punimeve, (sheshe, gradona dhe hapje gropash), procesin e mbjelljes së fidanëve pyjorë, sipas kushteve teknike;
- Mbikëqyr procesin e mbjelljes së fidanëve pyjorë, sipas standardeve;
- Inventarizon përqindjen e zënies së fidanëve pyjorë, sipas manualit;
- Zëvendëson fidanët pyjorë të dështuar, sipas procedurës të projektit;
- Mbikëqyr shërbimet kulturale në pyllëzime (ujtje, prashitje, plehërim. etj.), sipas parashikimit përkatës;
- Plotëson evidencat për punimet e kryera në pyllëzime, sipas formateve të kërkuara.

NjN-18-IV-0070-24 Inventarizimi dhe mbarështimi i pyjeve, kullotave, zonave të mbrojtura, faunës dhe bimëve mjekësore – eterovajore

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë qëllimin dhe objektivat për hartimin e planit të mbarështimit, inventarizimit të pyjeve, kullotave, Zonave të Mbrojtura (ZM), faunës dhe BMET;
2. Të shpjegojë përmbajtjen dhe përdorimin e udhëzuesit për hartimin e planeve të mbarështimit dhe inventarizimit;
3. Të rendisë elementet kryesor për hartimin e një plani të integruar mikrobazeni;
4. Të shpjegojë fazat e punës dhe termat e referencës për hartimin e planit të mbarështimit dhe inventarizimit;
5. Të shpjegojë të dhënat e përditësuara që merren nga kadastra pyjore;
6. Të shpjegojë mjetet dhe llojet e instrumenteve matës të elementeve dendrometrik që përdoren për inventarizim dhe mbarështim, si dhe përdorimin e tyre;
7. Të shpjegojë kriteret bazë të organizimit territorial të një ekonomie pyjore/kullosore, në parcela dhe nën/parcela si dhe shenjat kufitare përkatëse;
8. Të shpjegojë mënyrat e inventarizimit;
9. Të shpjegojë llojet e skedave të inventarizimit për sipërfaqen pyjore/kullosore;
10. Të shpjegojë elementët e formularit (skedës) të përshkrimit të parcelave, nën/parcelave, si dhe mënyrën e plotësimit në terren;
11. Të përshkruajë mënyrën e planifikimit të masave për zhvillimin e qendrueshëm dhe shumë funksional të një ekonomie pyjore, kullosore, ZM-ve, mbarështimit të gjahut dhe BMET-ve që përfshihen në Planin e Mbarështimit (PM);
12. Të shpjegojë mënyrat e llogaritjes së mundësisë vjetore të prerjeve të lejuara në grumbujt pyjor, përcaktimit të kapacitetit kullosor, përcaktimit të potencialit prodhues të bimëve mjekësore - eterovajore;
13. Të shpjegojë mënyrën e hedhjes së të dhënave të grumbulluara në terren;
14. Të shpjegojë mënyrën e klasifikimit të kullotave;
15. Të përshkruajë teknikat e kullotjes dhe infrastrukturën e nevojshme;
16. Të shpjegojë klasifikimin e Zonave të Mbrojtura sipas kategorive;
17. Të shpjegojë llojet e faunës së egër, karakteristikat dhe habitatet e tyre;
18. Të shpjegojë llojet e hartave që janë pjesë e PM-së dhe inventarizimit;
19. Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrën e përditësimit të të dhënave të planit të mbarështimit/inventarizimit në regjistrin kadastral të fondit pyjor, kullosor dhe regjistrin e faunës.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të marrë pjesë në inventarizimin e pyjeve, kullotave, zonave të mbrojtura, faunës, dhe bimëve mjekësore – eterovajore;
2. Të marrë pjesë mbarështimin e pyjeve, kullotave, zonave të mbrojtura, faunës, dhe bimëve mjekësore – eterovajore.

Kriteret e vlerësimit

- Merr pjesë në hartimin e planit të veprimit për realizimin e inventarizimit e pyjeve, kullotave, zonave të mbrojtura, faunës, dhe bimëve mjekësore – eterovajore, sipas udhëzuesve përkatës;
- Përdor mjetet dhe instrumentet matëse për inventarizim, sipas udhëzuesit përkatës;
- Merr pjesë në marrjen e të dhënave fillestare nga Kadastra pyjore për kryerjen e inventarizimit/mbarështimit, sipas udhëzuesit përkatës;
- Merr pjesë në kryerjen e materializimit në terren të sipërfaqeve provë të përhershme për inventarizim/mbarështim të grumbullit pyjor, kullotave, zonave të mbrojtura, faunës,

- dhe bimëve mjekësore – eterovajore, sipas udhëzuesit;
- Merr pjesë në hartimin e planit të veprimit për realizimin e mbarështimit të pyjeve, kullotave, zonave të mbrojtura, faunës, dhe bimëve mjekësore – eterovajore, sipas udhëzuesve përkatës;
- Përdor mjetet dhe instrumentet matëse për mbarështimin, sipas udhëzuesit përkatës;
- Zbaton kriteret e organizimit të terrenit në ekonomi pyjore në parcela dhe nën parcela;
- Bashkëpunon me inxhinierin e pyjeve në vendosjen e shenjave kufitare, për parcelat/nënparcelat/ekonominë pyjore, sipas kërkesave të manualit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave;
- Kryen matjet specifike në sipërfaqet provë, duke zbatuar metodologjitë përkatëse për inventarizimin/mbarështimin;
- Bashkëpunon për hartimin e planit të inventarizimit/mbarështimit, sipas udhëzuesit;
- Kontrollon në terren zbatimin e projekteve për punimet e përmirësimit të kullotave dhe vjeljes së BMET-ve, sipas udhëzuesit;
- Mbikëqyr zbatimin e teknologjisë së nxjerrjes së esencave, sipas llojeve drusore dhe BMET-ve;
- Kontrollon mënyrat e kullotjes, sipas periudhës;
- Plotëson evidencat e punimeve të zbatimit të planeve të mbarështimit/inventarizimit, sipas formateve të kërkuara.

NjN-17-IV-0071-24 Gjeodezi dhe planifikim territori

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë bazat teorike, metodat, pajisjet dhe instrumente e thjeshtë të matjes së elementeve topografikë;
2. Të shpjegojë elementet e hartës topografike dhe imazhet satelitore;
3. Të shpjegojë rëndësinë e zhvillimit të integruar dhe metodat kryesore të planifikimit dhe zhvillimit të peizazhit natyror;
4. Të shpjegojë planifikimin dhe zhvillimin e pyjeve urban dhe parqeve;
5. Të shpjegojë elementet e hartës topografike dhe imazhet satelitore;
6. Të shpjegojë mënyrën e organizimit të një hapësire të gjelbër në zona urbane;
7. Të listojë institucionet përgjegjëse në planifikimin e territorit.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të kryejë matje topografike me instrumente matës gjeodezik;
2. Të bashkëpunojë në planifikimin e territorit dhe hapësirave të gjelbra.

Kriteret e vlerësimit

- Kryen saktë matje me instrumente matës gjeodezie;
- Hedh në planshet të dhënat e grumbulluara, sipas manualit;
- Realizon saktë mbylljen e poligonit;
- Përcakton largësitë dhe kuotat e pikave në terren dhe në hartë, sipas manualit;
- Mat kënde horizontale dhe vertikale, sipas manualit;
- Mat sipërfaqe të parcelave gjatë punimeve të ndryshme, sipas manualit;
- Organizon hapësira të gjelbra në zona urbane, sipas projektit;
- Bashkëpunon me institucionet përgjegjëse për planifikimin e territorit.

NjN-18-IV-0072-24 Zbatimi i projekteve për mbarështimin e faunës dhe organizimin e gjuetisë

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë aktivitetet e parashikuara në zbatim e planit të mbarështimit të faunës;
2. Të përshkruajë projektet për zbatim të planit të mbarështimit të faunës së egër;
3. Të shpjegojë udhëzuesit për monitorimin e faunës së egër dhe habitateve;
4. Të përshkruajë planin vjetor të gjuetisë së një zone gjuetie;
5. Të përshkruajë kushtet kryesore të ushqimit, kripores, ujit dhe qetësisë që duhet të plotësojë një zonë gjuetie;
6. Të përshkruajë shënimin e kufijve të një zone gjuetie;
7. Të shpjegojë mënyrën e planifikimit dhe ndërtimit të objekteve të mbarështimit të gjahut;
8. Të përshkruajë funksionin e pikave të vrojtimit dhe mënyrën e shpërndarjes së tyre në terren;
9. Të shpjegojë llojet dhe mënyrat e plotësimit të evidencave për punimet që kryhen në kuadër të planit të mbarështimit të faunës pyjore;
10. Të përshkruajë mënyrën e organizimit të zonave të gjuetisë;
11. Të përshkruajë mënyrën e mbajtjes së procesverbaleve në rastin e shkeljeve;
12. Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të planit dhe kalendarin e gjuetisë së vjeljes së faunës së egër;
13. Të përshkruajë metodat kryesore të gjuetisë;
14. Të përshkruajë dokumentacionin e nevojshëm për zhvillimin e gjuetisë;
15. Të përshkruajë kategoritë e rrezikuara të llojeve të faunës pyjore.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të ndjekë zbatimin e projekteve të mbarështimit të faunës së egër, në bashkëpunim me inxhinierin (eprorin);
2. Të ndjekë zbatimin e planit vjetor të gjuetisë për çdo zone gjuetie.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton aktivitetet e parashikuara sipas planit të mbarështimit të faunës së egër;
- Monitoron faunën e egër dhe habitatet, sipas udhëzuesve të monitorimit;
- Merr pjesë në përcaktimin e kategorive të rrezikuara të faunës pyjore, sipas legjislacionit në fuqi;
- Ndjek gjuetinë, sipas zonave dhe kalendarit përkatës;
- Verifikon lejen e gjuetisë dhe dokumentacionin përkatës për ushtrimin e gjuetisë, sipas zonave;
- Kryen shënimin e kufijve të zonave të gjuetisë dhe pikat e vrojtimit në terren, sipas kriterëve përkatës;
- Mbikëqyr plotësimin e racioneve ushqimore në rezervate dhe zonat e gjuetisë, sipas normave të përcaktuara.
- Merr pjesë në kryerjen e inventarizimit të faunës së egër, sipas kërkesave të përcaktuara në manual;
- Plotëson evidencat e kryerjes së punimeve për mbarështimin e faunës së egër, sipas

formateve të kërkuara;

- Plotëson evidencat për vjeljen e kuotave të gjahut, sipas formateve;
- Plotëson procesverbalet në rastin e shkeljeve dhe kundravajtje në gjueti, sipas formateve.

NjN-18-IV-0073-24 Monitorimi dhe vlerësimi i gjendjes së fondit pyjor/kullosor, bimëve mjekësore – eterovajore dhe të faunës

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë udhëzuesit e monitorimit, rëndësinë dhe përdorimin e tyre;
2. Të shpjegojë treguesit e monitorimit dhe vlerësimit të gjendjes fitosanitare, të pyjeve, kullotave, bimëve mjekësore – eterovajore dhe të faunës, në fondin pyjor dhe kullosor, periudhën dhe mënyrat e monitorimit të tyre;
3. Të shpjegojë udhëzuesit për monitorimin e faunës së egër dhe habitateve;
4. Të shpjegojë rëndësinë dhe treguesit e monitorimit mbi faktorët natyrorë dhe shkallën (niveлин) e ndikimit të tyre mbi tokën, faunën dhe burimet natyrore, pyjore dhe kullosore (biodiversitetin);
5. Të shpjegojë mënyrat e organizimit të sistem vrojtım-sınjalizimit, shkaqet e rënies së zjarreve në pyje/kullota, klasifikimi dhe pasojat e tyre;
6. Të shpjegojë llojet e evidencave për monitorimin dhe mënyrën e plotësimit të tyre;
7. Të shpjegojë procedurat dhe afatet e dorëzimit të informacionit të grumbulluar.

Rezultatet e të nxënit në shprehı profesionale

1. Të bashkëpunojë për monitorimin e pyjeve, kullotave, Zonave të Mbrojtura, BMET-re dhe tokës, sipas kërkesave të akteve përkatëse
2. Të vlerësojë treguesit sasiorë dhe cilësorë mbi gjendjen e pyjeve, kullotave, Zonave të Mbrojtura, BMET-ve dhe tokës, sipas kërkesave të akteve përkatëse.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton aktet ligjore dhe nënlıgjore për monitorimin e fondit pyjor/kullosor, bimëve mjekësore – eterovajore, faunës, tokës pyjore/kullosore dhe biodiversitetit;
- Grumbullon të dhëna për treguesit sasior dhe cilësorë, sipas programit të monitorimit;
- Vlerëson dëmet e shkaktuara nga zjarri, prerjet e palıgjshme, sëmundjet, dëmtuesit dhe faktorëve natyrorë, në fondin pyjor/kullosor, sipas udhëzimeve përkatëse;
- Organizon sistemin e vrojtım-sınjalizimit, në zonën pyjore/kullosore, sipas kriterëve teknike;
- Grumbullon të dhëna për llojet e florës dhe faunës së egër të kërcënuara dhe në rrezik zhdukje, sipas programit të monitorimit;
- Identifikon në kohë dëmet e shkaktuara nga faktorët natyror mbi tokën;
- Plotëson dokumentacionin e nevojshëm për monitorimin, sipas formateve të kërkuar.

NjN-18-IV-0074-24 Mbikëqyrja e zbatimit të sigorisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në silvikulturë

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë parimet dhe rregullat kryesore të “Standardı ISO 45001” (Shëndeti dhe Siguria në Punë sipas standardeve ndërkombëtare);

2. Të shpjegojë standardet dhe legjislacionin shqiptar për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik;
3. Të shpjegojë mënyrat e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti sipas proceseve të punës që zbaton;
4. Të përshkruajë sinjalistikën në mjedisin e punës;
5. Të përshkruajë procedurat e evakuimit për raste emergjence sipas proceseve të punës;
6. Të përshkruajë përdorimin e pajisjeve të MZSH⁴;
7. Të shpjegojë masat përkatëse gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike;
8. Të përshkruajë llojet e mjeteve të ndihmës së parë dhe përdorimi i tyre;
9. Të përshkruajë karakteristikat e mjedisit të qëndrueshëm;
10. Të shpjegojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit për ndarjen e mbetjeve sipas llojit;
11. Të përshkruajë rregulloret përkatëse për depozitimin e mbetjeve;
12. Të përshkruajë rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit;
13. Të shpjegojë tabelat e sigurisë teknike;
14. Të shpjegojë masat parandaluese për zjarret;
15. Të përshkruajë rëndësinë dhe përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale dhe kolektive në punë;
16. Të përshkruajë protokollet që zbatohen në raste pandemie.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë standardet e sigurimit teknik në punë;
2. Të zbatojë procedurat për mbrojtjen e shëndetit;
3. Të zbatojë procedurat për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Kriteret e vlerësimit

- Mbikëqyr zbatimin e udhëzuesve përkatës në përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës, sipas operacioneve teknologjike;
- Mbikëqyr zbatimin e legjislacionit shqiptar për sigurimin teknik, sipas operacioneve teknologjike të punës;
- Ndjek respektimin e sinjalistikës së përcaktuar në mjediset e punës për sigurimin teknik të njerëzve dhe mjeteve;
- Monitoron gatishmërinë e mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme të mbrojtjes nga zjarri në mjedisin e punës, sipas manualeve përkatëse;
- Ndjek zbatimin e rregullave të parandalimit të zjarrit dhe fatkeqësive të tjera natyrore, sipas rregulloreve përkatëse;
- Ndjek zbatimin e rregullave për shuarjen e zjarrit, evakuimin e njerëzve dhe mjeteve, sipas udhëzimeve përkatëse;
- Ndjek zbatimin e rregullave të përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike sipas udhëzuesit përkatës;
- Identifikon dhe raporton tek personat përgjegjës për mosfunksionimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës dhe të mbrojtjes nga zjarri, sipas udhëzuesit përkatës;
- Ndjek zbatimin e rregullave të depozitimit, të ndarjes dhe të transportit të mbetjeve në përputhje me rregulloret e mbrojtjes së mjedisit;
- Ndjek përdorimin në mënyrë racionale të energjisë, ujit dhe materialeve të tjera të

⁴ Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi

- punës, si dhe zbatimin e rregullave për mbrojtje e mjedisit;
- Mbikëqyr vendosjen e tabelave paralajmëruese dhe sinjaleve të përcaktuara të sigurisë teknike në mjediset e punës, sipas udhëzimit.
- Ndjek plotësimin e inventarit të pajisjeve të mbrojtjes, ndihmës së shpejtë individuale dhe kolektive në punë sipas operacioneve dhe mjedisëve të punës, sipas udhëzuesit;
- Mbikëqyr dhënien e ndihmës së parë në rast aksidenti në punë, sipas procedurave.
- Ndjek pajisjen me vërtetimin mjekësor vjetor të gjendjes shëndetësor dhe aftësisë për punë, sipas udhëzuesve.
- Mbikëqyr zbatimin e protokolleve dhe masave të përcaktuara në raste pandemie apo situata të tjera të veçanta, sipas udhëzuesve.

NjN-23-IV-0005-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të kodit të etikës dhe rregullat e hierarkisë profesionale në komunikimin me eprorët dhe kolegët;
2. Të shpjegojë rolin e sipërmarrjes sociale dhe ekonomike në krijimin e një shoqërie të qëndrueshme;
3. Të përshkruajë fazat e zhvillimit të biznesit në kontekstin e globalizimit;
4. Të përshkruajë format e ndryshme të sipërmarrjes në lidhje me synimet kryesore të karrierës personale, mundësitë dhe përfitimet në komunitet;
5. Të shpjegojë konceptet bazë financiare (dokumentet financiare, institucionet financiare);
6. Të shpjegojë llogaritje të thjeshta ekonomike të një aktiviteti sipërmarrës;
7. Të listojë komponentët e hartimit të një buxheti për një sipërmarrje të vogël;
8. Të evidentojë mundësitë që ofron tregu i punës dhe kualifikimet e mëtejshme;
9. Të shpjegojë lidhjen dhe ndryshimin midis sipërmarrjes dhe menaxhimit;
10. Të shpjegojë funksionet themelore të organizimit të punës në biznes;
11. Të shpjegojë kuptimin dhe nevojën për menaxhimin e burimeve njerëzore (personelit), duke u përqendruar në mënyrën e drejtimit, integritetit, motivimit dhe mbikëqyrjes së tyre;
12. Të listojë mjetet e nevojshme për sigurimin, ruajtjen, vlerësimin dhe shpërndarjen e informacionit, për të realizuar vendim-marrje në biznes;
13. Të shpjegojë dobinë e marketingut në biznes;
14. Të shpjegojë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes;
15. Të shpjegojë konceptet dhe mjetet e nevojshme për sigurimin, ruajtjen, vlerësimin dhe shpërndarjen e informacionit për vendim-marrjen në biznes.
16. Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të legjislacionit tatimor, kodin e punës dhe legjislacionin lidhur me aktivitetin që kryen;
17. Të shpjegojë rëndësinë e plotësimit të planeve ditore, javore, mujore të punës, në përputhje me detyrat;
18. Të përshkruajë format dhe mënyrat e përpilimit dhe arkivimit të dokumentacioneve;
19. Të shpjegojë mënyrën e regjistrimit të faturave;
20. Të shpjegojë mënyrat e përgatitjes së një oferte për punimet/shërbimin që do të kryejë;
21. Të shpjegojë mënyrën e marrjes së informacionit mbi çmimet e tregut, të mjeteve, materialeve, instrumenteve matës dhe materialit mbjellës;
22. Të shpjegojë elementët e llogaritjes së kostos së mjeteve, materialeve, instrumenteve

- matës, materialit mbjellës dhe shërbimeve të kryera në bazë të projektit të dhënë;
23. Të shpjegojë mënyrat e blerjes së mjeteve, materialeve, instrumenteve matës dhe materialit mbjellës sipas projektit;
 24. Të shpjegojë elementet e llogaritjes e çmimit përfundimtare për punimet/shërbimet e ofruara;
 25. Të listojë llojet e dokumenteve për dorëzimin e punimeve dhe mënyra e përgatitjes së tyre;
 26. Të shpjegojë teknikat e duhura të marketingut për punimet/shërbimet që kryen;
 27. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të metodave të duhura në komunikim;
 28. Të shpjegojë rëndësinë e parimeve të punës në grup;
 29. Të përshkruajë metodat e zgjidhjes së problemeve dhe mendimit kritik;
 30. Të shpjegojë rëndësinë e respektimit të parimeve të barazisë gjinore, racore, kulturore, fetare etj.;
 31. Të shpjegojë metodat e zhvillimit profesional dhe të karrierës;
 32. Të listojë mënyrat e transmetimit në kohë tek bashkëpunëtorët të njohurive dhe aplikimin e teknikave të reja në punë;
 33. Të shpjegojë domosdoshmërinë e pjesëmarrjes në panaire dhe ekspozita.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të hartojë dhe menaxhojë një plan të thjeshtë biznesi me bazë në pyje dhe kullota;
2. Të zbatojë kodin e etikës dhe rregullat e hierarkisë profesionale në komunikimin me eprorët dhe kolegët;
3. Të identifikojë nevojat për zhvillim të vazhdueshëm profesional dhe të karrierës;
4. Të zbatojë teknologjitë e reja për të arritur një komunikim të shpejtë dhe korrekt me të tjerët.

Kriteret e vlerësimit

- Kryen llogaritje të thjeshta ekonomike të një aktiviteti sipërmarrës;
- Plotëson dokumentacionin e lëvizjes së mallrave, shërbimeve dhe veprimeve kryesore me bankën, sipas formate;
- Plotëson regjistrat e ditëve të punës dhe pagesave, sipas formateve;
- Plotëson akt-marrje dhe situacione sipas punimeve;
- Harton një plan të thjeshtë biznesi me bazë në pyje dhe kullota;
- Llogarit koston e prodhimit, sipas të dhënave;
- Përgatit ofertat për punimet/shërbimet që do të kryejë, sipas kërkesave;
- Llogarit çmimin përfundimtar për punimet/shërbimet e ofruara, sipas manualit;
- Plotëson procesverbalin/dokumentin e dorëzimit, sipas porosisë së klientit;
- Zbaton kodin e etikës dhe rregullat e hierarkisë profesionale në komunikimin me eprorët dhe kolegët, sipas rregullores së brendshme;
- Zgjidh ankesat dhe mosmarrëveshjet me klientët, duke përdorur teknikat e duhura;
- Zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kulturore, fetare, etj.

NjN-18-IV-0075-24 Florikultura

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë mënyrat e kultivimit të luleve një dhe shumëvjeçare;
2. Të shpjegojë shumëzimin e bimëve

3. Të listojë shërbimet që kryhen në lultari;
4. Të shpjegojë hartimin e një projekt gjelbërimi në sipërfaqe të vogla.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të kryejë shërbime dhe punime në lultari;
2. Të zbatojë një projekt gjelbërimi në sipërfaqe të vogla.

Kriteret e vlerësimit

- Kultivon lulet një dhe shumëvjeçare në mjedise të hapura dhe të mbyllura sipas qëllimit të përdorimit;
- Kryen shumëzimin e bimëve me farë dhe në mënyrë vegjetative, sipas kulturës bimore;
- Kryen shërbime dhe punime në lultari, sipas projektit;
- Zbaton një projekt gjelbërimi në sipërfaqe të vogla.

NjN-18-IV-0076-24 Teknologjia e shfrytëzimit pyjor

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë procesin teknologjik të prodhimit të lëndës në pyll dhe fazat e tij;
2. Të listojë asortimentet e nxjerra nga shfrytëzimi i pyjeve;
3. Të shpjegojë mënyrat e transportit të brendshëm në shfrytëzimin pyjor;
4. Të shpjegojë strukturën e shfrytëzimit të pyllit sipas proceseve teknologjike;
5. Të shpjegojë mënyrën e llogaritjes së sipërfaqeve të skelave dhe shesheve të stivimit të përkohshëm të materialit drunor;
6. Të shpjegojë humbjet gjatë fazave të procesit teknologjik të shfrytëzimit;
7. Të listojë rregullat e sigurimit teknik në punë gjatë organizimit të punës për prerjen, transportin dhe ngarkimin e materialit drusor;
8. Të shpjegojë teknikën e vjeljes, manipulimit dhe ruajtjen e prodhimeve të dyta pyjore;
9. Të shpjegojë teknikën e nxjerrjes së esencave nga llojet drusore dhe barishtore.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të ndjekë zbatimin e projekteve të shfrytëzimit të ngastrës pyjore/ grup ngastrave pyjore të caktuara për shfrytëzim si dhe transportin e materialit drusor që rezulton nga shfrytëzimi;
2. Të dokumentojë ecurinë e punës gjatë gjithë fazave të shfrytëzimit të ngastrës pyjore/ grup ngastrave pyjore të caktuara për shfrytëzim si dhe transportin e materialit drusor që rezulton nga shfrytëzimi.

Kriteret e vlerësimit

- Organizon punën në shfrytëzimin e ngastrave pyjore, sipas planit tekniko-ekonomik;
- Organizon brigadën komplekse të shfrytëzimit të pyllit dhe radhën e punës në shfrytëzimin e ngastrave pyjore, sipas planit tekniko-ekonomik;
- Zbaton skemën teknologjike të shfrytëzimit të ngastrës pyjore/grup ngastrave pyjore, sipas planit tekniko-ekonomik;
- Mbikëqyr përdorimin e instrumenteve dhe makinerive për rrëzimin dhe përpunimin e parë në pyll të drurit dhe mirëmbajtjen e tyre, sipas manualeve dhe udhëzuesve teknik;
- Mbikëqyr asortimin e drurit të rrëzuar, transportin e brendshëm, stivimin, markimin,

ngarkimin e lëndës drusore me vegla dore apo me mekanizma të thjeshtë, sipas planit tekniko-ekonomik;

- Ndjek zbatimin e rregullave të sigurimit teknik gjatë gjithë fazave të procesit teknologjik të shfrytëzimit;
- Plotëson dokumentacionin e lëvizjes së materialit drusor sipas rregullave dhe kërkesave të përcaktuara;
- Ndjek procesin e hapjes së rrugëve pyjore dhe punimeve të tjera, sipas projektit.

NjN-18-IV-0077-24 Ligjshmëria pyjore

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë bazën ligjore dhe nënligjore në fuqi për administrimin e fondit pyjor/kullosor;
2. Të shpjegojë bazën ligjore dhe nënligjore në fuqi për Zonat e Mbrojtura;
3. Të shpjegojë bazën ligjore dhe nënligjore në fuqi për gjuetinë;
4. Të shpjegojë bazën ligjore dhe nënligjore në fuqi për bimët mjekësorë etero-vajore;
5. Të shpjegojë bazën ligjore dhe nënligjore në fuqi për Mbrojtje e Mjedisit;
6. Të shpjegojë bazën ligjore dhe nënligjore në fuqi për Mbrojtje e tokës;
7. Të shpjegojë Sistemin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (SRPP)
8. Të shpjegojë bazën ligjore dhe nënligjore në fuqi për Lejet, Licencat, Autorizimet, për ushtrimin e veprimtarive, aktiviteteve të ndryshme në fondin pyjor, kullosor;
9. Të shpjegojë legjislacionin tatimor dhe kodin e punës.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë bazën ligjore dhe nënligjore për: administrimin e fondit Pyjor/Kullosor, Zonat e Mbrojtura, Gjuetinë, Bimët Mjekësorë Etero - Vajore Natyrore, Mbrojtjen e Mjedisit, Mbrojtjen e Tokës. Lejet, Licencat, Autorizimet, si dhe legjislacionin Tatimor e Kodin e Punës.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton bazën ligjore dhe nënligjore në fuqi për administrimin e fondit pyjor/kullosor,
- zonat e mbrojtura, gjuetinë, BMTE-të dhe biodiversitetin;
- Zbaton bazën ligjore dhe nënligjore në fuqi për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Mbrojtjen e tokës;
- Zbaton bazën ligjore dhe nënligjore në fuqi për Lejet, Licencat, Autorizimet, për ushtrimin e veprimtarive, aktiviteteve të ndryshme në fondin pyjor/kullosor;
- Zbaton legjislacionin tatimor dhe kodin e punës.

Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:

Nr.	Njësi të nxëni	Peshat në %	Kodet
1	Planifikimi dhe organizimi i punës në silvikulturë	10	NjN-18-IV-0066-24

2	Mbikëqyrja dhe zbatimi i masave silvikulturale	10	NjN-18-IV-0067-24
3	Mbikëqyrja e procesit të prodhimit të materialit mbjellës	10	NjN-18-IV-0068-24
4	Zbatimi i projekteve të pyllëzimit	10	NjN-18-IV-0069-24
5	Inventarizimi dhe mbarështimi i pyjeve, kullotave, zonave të mbrojtura, faunës, dhe bimëve mjekësore – eterovajore	15	NjN-18-IV-0070-24
6	Gjeodezi dhe planifikim territori	5	NjN-17-IV-0071-24
7	Zbatimi i projekteve për mbarështimin e faunës dhe organizimin e gjuetisë	5	NjN-18-IV-0072-24
8	Monitorimi dhe vlerësimi i gjendjes së fondit pyjor/kullosor, bimëve mjekësore – eterovajore dhe të faunës	10	NjN-18-IV-0073-24
9	Mbikëqyrja e zbatimit të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në silvikulturë	5	NjN-18-IV-0074-24
10	Sipërmarrje dhe edukim karriere	5	NjN-23-IV-0005-24
11	Florikultura	5	NjN-18-IV-0075-24
12	Teknologjia e shfrytëzimit pyjor	5	NjN-18-IV-0076-24
13	Ligjshmëria pyjore	5	NjN-18-IV-0077-24
Total		100%	

Modalitetet e vlerësimit

Me vlerësim kuptojmë procesin gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së një rezultati të nxëni (RN), mbi bazën e kriterëve të caktuar.

Për vlerësimin mund të përdoren një shumëllojshmëri metodash standarde dhe inovatore. Individit i nënshtrohet vlerësimit të vazhduar, përmbledhës dhe vlerësimit përfundimtar për kualifikimet formale që ofrohen në ofrues të akredituar.

Individi vlerësohet për shkallën e përvetësimit të kompetencave të përgjithshme dhe profesionale, të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën përkatëse dhe vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së RN për realizimin e tërësisë së proceseve duke mbajtur evidenca për qëllime dokumentimi.

Realizimi i pranueshëm do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të specifikuar.

Dhënia e rezultatit të vlerësimit bëhet sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Kompetencat e përgjithshme vlerësohen te integruara si pjesë e vlerësimit të njësive të të nxënit.

Individit i lind e drejta të certifikohet për njësitë të nxëni specifike, si një kualifikimi i pjesshëm sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Informacion shtesë

Kualifikimet e plota ose të pjesshme profesionale mund të përftohen nëpërmjet këtyre formave:

- a) ndjekjes së arsimit profesional me bazë shkollën;
- b) ndjekjes së kurseve profesionale, ku përfshihen edhe praktikat profesionale në ndërmarrje apo forma të tjera të mësim nxënies praktike;
- c) regjistrimit si nxënës, duke u punësuar në një ndërmarrje (forma e dyfishtë);
- ç) njohjes të të nxënit të mëparshëm informal dhe joformal;
- d) njohjes të të nxënit të përfutur jashtë vendit;
- dh) formave të tjera të përcaktuara me ligj.

SHËNIM

Shpjegime të kodit të kualifikimit: **S1-IV-24**

S - Shkronja që identifikon fushën e kualifikimit

1 - Numri që identifikon profilin/specializimin e kualifikimit përkatës

IV - Shifra që identifikon nivelin sipas KSHK

24 - Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar kualifikimi

Shpjegime të kodit të njësisë së të nxënit: **NjN-18-IV-0066-24**

NjN - Shkronjat që tregojnë se kodi i referohet Njësive të të Nxënit

18 - Numri që identifikon orientimin e Njësisë së të Nxënit

IV - Shifra që tregon nivelin e Njësisë së të Nxënit në strukturën e KSHK

0066 - Numri rritës progresiv që tregon gjendjen e Njësive të të Nxënit në ditën e hartimit përkatës

24 - Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar Njësia e të Nxënit